



Prishtinë, 10.07.2026
Kodi i ZRRE-së: V_3281_2026

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_2917_03_26** i datës 19.03.2026;
- Kundërshtimi i KESCO-s i dt. 20.04.2026.

në seancën e mbajtur më datë 10.07.2026 nxori këtë:

V E N D I M

- I. REFUZOHET** Kundërshtimi i KESCO-s, lidhur me konsumatorin **A M.**, si i pabazuar.
- II. MBETET** në fuqi, vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRe, me nr. ZRRE/DMK_V_2917_03_26 i datës 19.03.2026.
- III.** Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
- IV.** Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit të tij nga Bordi i ZRRE-së, dhe i njëjti do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

A r s y e t i m

Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRe, me datë 19.03.2026 ka marrë Vendim me nr. ZRRE/DMK_V_2917_03_26 me të cilin e ka aprovuar si të bazuar ankesën e konsumatorit A. M., me shifër DPR - 90114185 dhe e ka obliguar KESCO-n, që konsumatorit t'i anuloi korrigjimin financiar të dt. 25.08.2025, dhe për periudhën kohore prej 02/2025 – 05/2025, ta korrigjojë në vlerë financiare prej -116 €.

Të pakënaqur me Vendimin e DMK-së, Furnizuesi KESCO brenda afatit ligjor ka paraqitur Kundërshtim në Bordin e ZRRe-së, për këto shkaqe:

- Shpenzimi i regjistruar në njehsorin elektrik me nr. 64687590 është i saktë dhe mos faturimi me rregull i konsumatorit, nuk nënkupton matje jo të saktë të shpenzimit të tij;
- Korrigjimi i kontestuar, është i mbështetur në gjendjet e regjistruara në njehsorin elektrik, sepse njehsori është SMART dhe e bën ruajtjen e të dhënave;
- Çdo shpërndarje tjetër e këtyre kWh, në mënyrë proporcionale, është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi dhe kërkojnë pezullimin e vendimit të DMK-së;

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 10.07.2026 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuara nga palët në kontest, si dhe vendimin e Departamentit për



Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji ka administruar këto prova: Kundërshtimin e KESCO-s të dt. 20.04.2026; Vendimin e DMK-së të dt. 19.03.2026, Ankesën e konsumatorit në DMK e dt. 29.08.2025, Transaksionet e konsumatorit me shifër DPR – 90114185, Rrjedhën e energjisë elektrike, Listat e leximit dhe Korrigjimin Financiar të dt. 25.08.2025, si dhe dokumentet e tjera si në shkresat e lëndës. Pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se Kundërshtimi i KESCO-s është i pabazuar, sepse:

Bazuar në rrjedhën e energjisë elektrike dhe analizimit të listave të leximit konstatohet se punëtorët e autorizuar të KEDS për leximin e pikave matëse kanë bërë inspektime të rregullta mujore dhe nuk është evidentuar asnjë parregullsi në këtë pikë matëse. Gjithsesi, duke filluar nga muaji 02-05/2025, në Lista të Leximit për këtë pikë matëse, është evidentuar si “Metter inside” ose Njehsori brenda dhe konsumatori për këtë periudhë është faturuar vetëm me taksë fikse në vlerë financiare **2.16 €**. Kurse në periudhën 05/2025 (**periudha kontestuese**), konsumatori është lexuar përmes Sondës, dhe është faturuar sipas gjendjeve të nxjerra nga njehsori. Po ashtu, vihet re që, edhe në periudha të mëparshme kohore, konsumatori nuk është lexuar dhe faturuar sipas shpenzimeve të tij, si pasojë e mos qasjes së punëtorëve të autorizuar të KEDS për lexim dhe faturim të rregullt të shpenzimeve të tij.

Bordi thekson se, pamundësimi i punëtorëve të autorizuar të KEDS të ta lexojnë pikën matëse, është në kundërshtim me nenin 25 – Qasja në pronë të konsumatorit, të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji Elektrike, si vijon: *“Konsumatori është i obliguar që të ju lejojë qasje në pronën e tij, përfaqësuesve të Operatorit të Sistemit/Furnizuesit, për qëllim të leximit, testimit, inspektimit, instalimit, mirëmbajtjes, riparimit të matësve, kyçjeve dhe pajisjeve përkatëse ashtu si paraqitet në Nenet 28, 29 dhe 30 të Ligjit për Energji. 2. Nëse konsumatori nuk lejon qasje për leximin e pajisjeve matëse edhe pas marrjes së njoftimit me shkrim, energjia e furnizuar do të faturohet bazuar në mesataren e faturave gjatë tre (3) muajve të mëparshëm”*, dhe se konsumatori ka vepruar në kundërshtim me këtë dispozitë ligjore, sepse është dashur që të iu lejojë qasje punëtorëve të autorizuar të KEDS në pikën matëse për lexim dhe faturim të saktë të shpenzimeve mujore. Kësisoj, për periudhën 02-05/2025 që punëtorët e autorizuar të KEDS nuk kanë pasur qasje në pikën matëse të konsumatorit, i njëjti është faturuar me taksë fikse, ndërkaq, pasi që është mundësuar qasja e ekipeve të KEDS në pikën matëse, në muajin 05/2025, konsumatori është faturuar sipas gjendjes së shpenzimit në njehsor. Gjithsesi, kjo faturë, paraqet faturë të grumbullimit të shpenzimeve të energjisë elektrike, për periudhën kohore që konsumatori nuk është lexuar, si pasojë e mos qasjes në pikën matëse të konsumatorit dhe nuk paraqet faturë të shpenzimit të krijuar për një muaj.

Bordi e ka shqyrtuar Korrigjimin Financiar me nr. 108776DPR– 90114185-90114185, i dt. 26.08.2025, në vlerë prej **-2.78 €**, të bërë nga Departamenti i faturimit në KESCO, në të cilin është evidentuar si vijon: *“Lexim jo i rregullt. Shpërndarje e kWh për periodën 02-05/2025, duke u bazuar në ankesën e konsumatorit dhe lexime Sondë”* dhe ka gjetur se KESCO ka vepruar konform nenit 28 paragrafit 3 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji Elektrike ku thuhet se: 3. *“Në rast të gabimeve që rrjedhin prej të dhënave të leximit të pasaktë të njehsorit, të cilat shkaktojnë faturim të pasaktë, Furnizuesi do të bëjë të gjitha korrigjimet (rregullimet) e nevojshme në faturën vijuese”*, por



që, pas rivlerësimit të DMK-së, si i tillë nuk është i saktë, ashtu që, shkalla e parë në ZRRE, me të drejtë ka vendosur që konsumatorit duhet t'i bëhet shpërndarje e kWh të grumbulluara nga muaji 02-2025 – 05/2025, dhe korrigjimi financiar rezulton të jetë **-116.33 €**.

Tutje, Bordi thekson se, duke u bazuar në nenin 5 – Furnizimi me Energji elektrike – të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji Elektrike, *“të gjithë konsumatorët e kanë për obligim që të paguajnë për energjinë elektrike të shfrytëzuar sipas kontratës për furnizim me energji të lidhur me furnizuesin e energjisë, si dhe për tarifat për shfrytëzim të sistemit të miratuara nga ZRRE-ja”*, andaj konsumatori e ka për obligim që të paguaj energjinë elektrike të cilën e ka shpenzuar.

Bordi i ZRRE pas analizave të bëra dëshmime dhe argumenteve të paraqitura nga palët e në veçanti Faturave të kontestuara, të dhënave të pranuar nga NQ Termokos, si dhe Rregullën për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimi të Vendimit ose nga data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Ymer Fejzullahu, Kryesues

Lutfije Dervishi, Anëtare

Gani Buçaj, Anëtar

Arta Isufi, Anëtare

Adnan Preniqi, Anëtar

Vendimi u dërgohet:

- KESCO;
- Konsumatorit **A. M.**
- Arkivit të ZRRE-së